



Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në mbledhjen e mbajtur me datën 09.09.2022 morri vendim që të shpallë:

## **KONKURS PLOTËSUES PËR STUDIME BAÇELOR**

**për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2022/2023**

### **I. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

1. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) në vitin e parë të studimeve, në afatin plotësues të konkursit për vitin akademik **2022/2023**, do të regjistrojë **220** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 %, përkatësisht deri në **56** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë, do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci, Medvegja deri 1% përkatësisht 7 studentë, si dhe 1% përkatësisht 7 studentë nga Maqedonia e Veriut, 1% përkatësisht 7 studentë nga Shqipëria, dhe 1% përkatësisht deri 7 studentë nga Mali i Zi. Kandidatët, të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'i nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim sikurse kandidatët nga Kosova.
4. Përfundimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2 dhe 3, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
5. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësime për pranim, nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
6. Të drejtë pranimi në Universitet kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë, në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
7. Në Universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
8. Kandidatë jo-kosovarë, konsiderohen kandidatët, të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'u verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHTI, e cila u dorëzohet të gjitha njësive akademike.
9. Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të dokumentohet në bazë të nostrifikimit nga organet kompetente. Vendimi për njohjen dhe barasvlerën e diplomës merret në MASHTI.
10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim.
11. Njësitë akademike përkatëse, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti joshumicë, bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.

12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 383 të Kodit Penal (KODI NR. 06/L-074) të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale.
13. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u regjistruar nga programi aktual i studimeve.**
14. **Kandidatët për pranim si studentë të UShAF në vitin akademik 2022/23 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se në një program të studimit.**

## **II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE**

1. **Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:**
    - a) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**  
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
      - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
      - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
    - b) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**  
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
      - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
      - Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
      - Pikët nga lëndët prioritare (3 lëndë) deri në 40 pikë.
- Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit më së shumti me 5 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
  3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen, edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
  4. Përgjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafin 2 dhe 3 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
  5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
  6. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e UShAF.
  7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë së njëjtë, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.
  8. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

## **III. AFATET E KONKURSIT**

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:**

1. Aplikimi online fillon nga data **12.09.2022** dhe **zgjatë deri më 19.09.2022** në ora 16.00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **12.09.2022**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 10.00.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **12.09.2022** deri më datën **19.09.2022** (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të të dielave). Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës.

4. **Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
- Certifikatën e lindjes (origjinal),*
  - Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal apo të noterizuara ose dublikat),*
  - Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme (origjinal apo të noterizuar ose dublikat),*
  - Certifikatën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal apo të noterizuar ose dublikat),*
  - Kopjen e letërnjoftimit,*
  - Fletëparaqitjen e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: [www.ushaf.net/apliko](http://www.ushaf.net/apliko)***
  - Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*

Konform Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 09/2021 të MASHTI, kandidatët që aplikojnë për studimet bachelor, lirohen nga pagesa për aplikim apo për provim pranues.

- Me rastin e aplikimit të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 4 t'i dorëzojnë në Administratën e Universitetit në dosje (fasikël) të bardhë (e pashënuar me emër dhe mbiemër).**
  - Dokumentet në pikën b) dhe c) mund të pranohen duplikat vetëm nëse dëshmohen me vërtetim nga organet kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje, etj. P.s. PAS NXJERRJES SË DOKUMENTEVE DUBLIKAT, DOKUMENTET ORGJINALE NUK MUND TË SHFRYTËZOHEN NGA KANDIDATI, PASI QË KY VEPRIM KONSIDEROHET VEPËR PENALE.**
  - Njoftimet dhe oraret, ku do të mbahen provimet pranuese, mund të merren në ueb faqen e Universitetit. Data e mbajtjes së provimeve pranuese në Universitet do të jetë me 20.09.2022 ora 9.00.**
  - Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**
  - Shpallja e rezultateve të provimit pranues dhe rezultateve preliminare bëhet, më së voni, deri më 21.09.2022, ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen më 23.09.2022 në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqen e Universitetit.**
  - Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.
  - Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'i drejtohen Administratës Qendrore ose ta vizitojnë faqen e Universitetit [www.ushaf.net](http://www.ushaf.net)
  - Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UShAF për të gjitha programet me datën 24.09.2022 dhe 26.09.2022**
  - Kandidatët, të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më 28.09.2022 deri në ora 16.00. Jashtë këtij afati, kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, dhe e humbin të drejtën e regjistrimit. Vendet e tyre do të plotësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar, duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.**
- Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
- Në qoftëse kandidati i pranuar në afatin e caktuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga drejta e regjistrimit.
- Nëse vendet e rezervuara për komunitetet jo shumicë dhe për shqiptarët jashtë Kosovës nuk do të plotësohen, atëherë vendet e tyre do të zëvendësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar, duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.
- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
    - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit;
    - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale;

#### **IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË**

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund të paraqesin ankesë pas publikimit të rezultateve preliminare, përkatësisht me datën **22.09.2022** nga ora **8:00** deri **16:00**. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave.

2. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të UShAF me datë **27.09.2022**.

## I. UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve bachelor në këtë afat të konkursit do të regjistrojë **220** studentë në fakultetet si në vijim:

Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvexha 1%	Kandidatët nga Shqipëria 1%	Kandidatët nga Maqedonia 1%	Kandidatë nga Mali i zi 1%	Gjithsej
<b>Gjithsej</b>	<b>136</b>	<b>56</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>220</b>
<b>Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit</b>	<b>51</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>74</b>
Programi Arkitekturë i Interierit dhe Dizajni i Mobileve	8	8	1	1	1	1	20
Programi: Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve të Drurit	43	7	1	1	1	1	54
<b>Fakulteti i Arteve të Aplikuara</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>9</b>
Programi: Dizajn Grafik dhe Multimedia	0	5	1	1	1	1	9
<b>Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit</b>	<b>15</b>	<b>10</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>29</b>
Programi Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit	15	10	1	1	1	1	29
<b>Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë</b>	<b>48</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>70</b>
Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë	34	7	1	1	1	1	45
Programi Informatik e Aplikuara	14	7	1	1	1	1	25
<b>Fakulteti i Menaxhimit</b>	<b>22</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>38</b>
Programi: Menaxhimi i biznesit dhe Ndermarresia	22	12	1	1	1	1	38
<b>TOTALI</b>	<b>136</b>	<b>56</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>220</b>

## **PROVIMI PRANUES**

Provimi pranues për kandidatët, të cilët nuk kanë të kryer maturën mbahet nga lëndët e lëmive të ngushta profesionale, të programeve të fakultetit dhe atë:

- Në Programin: Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit, nga lëndët: Ekonomi, Matematikë, Informatikë;
- Në Programin: Inxhinieri Industriale me Informatikë, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Informatika e Aplikuar, nga lëndët: Matematikë, Informatikë, Fizikë;
- Në Programin: Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia, nga lëndët: Ekonomi, Matematikë, Informatikë;
- Në Programin: Dizajn Grafik dhe Multimedia, nga lëndët: Art, Informatikë, Web Dizajn

Për kandidatët me maturë, përzgjedhja do të bëhet sipas lëndëve prioritare dhe atë sipas programeve në vijim:

### **I. Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit**

1. Informatikë;
2. Matematikë;
3. Ekonomi.

### **II. Inxhinieri Industriale me Informatikë**

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

### **III. Informatika e Aplikuar**

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

### **IV. Arkitekturë e Interierit dhe Dizajn i Mobilieve**

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

### **V. Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri**

1. Matematikë;
2. Informatikë;
3. Fizikë.

### **VI. Dizajn Grafik dhe Multimedia**

1. Art;
2. Informatikë;
3. Web Dizajn.

### **VII. Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia**

1. Informatikë;
2. Matematikë;
3. Ekonomi.